



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. Ilir Konushevi, Nr.8, 10000 Prishtinë
info@pak-ks.org – www.pak-ks.org

E Premte, 22 tetor 2010

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Ndërmarrjet e reja “Jatex- Fabrika e re” SH.P.K. dhe “Jatex Kompleksi Industrial” SH.P.K tërhiqen nga Vala e veçantë 45-A e privatizimit

PRISHTINË – Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ka tërhequr sot nga Vala e veçantë 45-A e Privatizimit, Ndërmarrjet e reja “Jatex- Fabrika e re” SH.P.K. dhe “Jatex Kompleksi Industrial” SH.P.K. Këto ndërmarrje ishin paraparë të privatizohet me datë 27 Tetor përmes Valës 45-A, bashkë me 12 Ndërmarrje Shoqërore(NSH), prej të cilave janë krijuar 15 Ndërmarrje të Reja (Ndër. të Reja).

Më poshtë mund të gjeni listën e plotë të ndërmarrjeve që do të jenë në dispozicion në Valën 45-A e cila do të mbahet me datë 27 Tetor 2010.

•**Ndërmarrja e Re Fabrika e duhanit Bair SH.P.K.** përbëhet nga prona e përkrahur sipas parcelës nr. 2881 dhe Certifikatës pronësore për prone me nr. 1573, me lokacion në lagjen e Bairit - në Komunën e Mitrovicës, dhe ka sipërfaqe të përgjithshme prej 1 ha 18 ari 92 m². Në kuadër të kësaj hapësire ndodhet ndërtesa me sipërfaqe prej rreth 6.000 m². Prona e ofruar e Ndërmarrjes së Re Fabrika e duhanit Bair SH.P.K. gjenden në një lokacion shumë të frekuentuar në rrugën Ibrahim Popoci në Mitrovicë.

•**Ndërmarrja e Re Boksitet e Kosovës Sh.P.K.** është miniera e vetme e boksiteve në Kosovë. Oferta përfshin punëtorinë, seperacionin, prodhimi i llaqit të thatë, uji industrial, makineri dhe pajisje dhe gjithashtu trupat minierar të shtrirë në një sipërfaqe prej përafërsisht 220 ha dhe gjithashtu licencën për hulumtim. Ndërtesat kane qasje të lehtë në hekurudhë ndërkombëtare.

•**Ndërmarrja e Re Deva Fabrika e Përpunimit të Kromit SH.P.K.** ofron një mundësi shumë të mirë investimi në blerjen e uzinës së vetme për përpunimin e kromit në atë zonë me asetet kryesore, siç janë regjistruar në Fletën Poseduese nr. 68, ZK Devë, Fshati Devë në komunën e Gjakovës. Asetet e tenderuara të Ndërmarrjes së Re përbëhen nga një kompleks parcelash tëke industriale nr. 119, 126 dhe 133 me sipërfaqe totale rreth 4 ha 79 ari 41 m², uzina e përpunimit të kromit me makineri, 4 objekte me sipërfaqe të përgjithshme rreth 2.000 m² (administrata, laboratorit dhe dy magazinat).

Për më shumë informata ju lutemi kontaktoni Znj. Arta Gosalci në arta.gosalci@pak-ks.org
apo në 038 500 400 lokali 1110

•**Ndërmarrja e Re Emin Duraku Edico Sh.P.K** përfshin tokën me sipërfaqe prej rreth 1 ha 47 ari 40 m² -Fleta Poseduese nr. 967, ZK Gjakovë në komunën e Gjakovës, ndërtesën që përfshin një sipërfaqe rreth 6.444 m², makineritë, trafon, cisternën e mazutit dhe kazanin e ngrohjes qendrore. Ndërmarrja e Re është e vendosur në lokacion primar industrial dhe përgjate saj ka dalje në rrugën kryesore në hyrje të qytetit.

•**Ndërmarrja e Re Emin Duraku Kompleksi Industrial Sh.P.K.** përfshin tokën me sipërfaqe rreth 10 ha, Fleta Poseduese nr. 967, ZK Gjakovë-në Komunën e Gjakovës, dhe kompleksin industrial të ndërtesave me sipërfaqe rreth 42.910 m².

•**Ndërmarrja e Re Hotel Onix Banja e Pejës dhe Ilixhe SH.P.K.** - I ofron investitorëve potencial mundësinë për të blerë hotele dhe Ilixhe në Banjë, regjioni i Pejës në një sipërfaqe prej përafërsisht 26 ha dhe më shumë se 38.000 m² sipërfaqe të ndërtesave. Ndërmarrja posedon me burim të ujit që ka fuqi shëruese dhe është i vetmi në Kosovo dhe një nga të pakët në regjion.

•**Ndërmarrja e Re Marketing Export Sh.P.K.** – ju ofron blerësve potencial mundësi për blerjen e ndërtesës me një sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 9 ari 75 m² dhe toka nën ndërtesë me të njëjtën sipërfaqe prej përafërsisht 9 ari 75 m² që gjendet përballë Mensës së Studentëve.

•**Ndërmarrja e Re Amortizatorët - Ndërtesa Administrative SH.P.K.** - ju ofron blerësve potencial mundësi për blerjen e ndërtesës administrative me sipërfaqen bazë prej përafërsisht 25 ari dhe tokën me një sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 5 ha 20 ari 60 m² që gjendet në pjesën më atraktive të Zonës Industriale në Prishtinë dhe mund të përdoret për aktivitete të ndryshme afariste.

•**Ndërmarrja e Re Fabrika e Amortizatorëve SH.P.K.** - ju ofron blerësve potencial mundësi për blerjen e fabrikës së amortizatorëve si fabrikë e vetme në rajon që prodhon amortizatorë të llojeve të ndryshme. Kjo ofertë përfshinë një sipërfaqe prej përafërsisht 8 ha 28 ari 70 m², përfshirë këtu hallën kryesore të prodhimit, hapësirë depoje, ndërtesën administrative bashkangjitur me hallën kryesore të prodhimit, laboratorët dhe hapësirë për shërbime tjera, në një pjesë shumë atraktive në Zonën Industriale të Prishtinës.

•**Ndërmarrja e Re Zdruktaria SH.P.K.** shtrihet në një sipërfaqe prej 59 Ari 20 m² dhe përfshin ndërtesën e administratës, shitoret si dhe disa objekte të prodhimit. Lokacioni ndodhet në rrugën “Shtjefën Gjeqovi” në Prizren. Aktualisht Ndërmarrja nuk operon. Që nga viti 2002 Ndërmarrja është komercializuar dhe aktualisht Ndërmarrja e Komercializuar NPMN “EGI-BAU” është duke operuar.

•**Ndërmarrja e Re Pylltaria - Ndërtesa Administratës Suharekë SH.P.K.** Prona e ndërmarrjes përfshinë ndërtesën e administratës që ndodhet në Suharekë me një sipërfaqe prej 33 ari 44 m².

•**Ndërmarrja e Re Remont Servisi SH.P.K.** Ndërtesat e Ndërmarrjes ndodhen ne zonen industriale te Prizrenit dhe perfshijne nje siperfaqe prej 1 ha 14 ari 4 m² dhe perfshine ndertesën e administrates , punishte depo etj.

•**Ndërmarrja e Re Liria “Depoja e Tekstilit” SH.P.K.** Lokacioni/kompleksi komercial për tu bartur në Ndërmarrjen e Re përshin një sipërfaqe totale prej 2.644 m². Kompleksi komercial (depoja e tekstilit) ndodhet në rrugën “I.C.Kavaja”/”Lekë Dukagjini” p.n. në qendër të qytetit të Prizrenit. Aktualisht i tërë kompleksi komercial është i dhënë me qira palëve të treta, përvec dy shitore që janë të mbyllura.

FUND